Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gjemajli Bellanica	**25.08.2023**	**08.09.2023**	**2023/0592**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.08.2023, OE "KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0592, , kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGMA INTERALBANIAn VIENNA INSUARCE GROUP SH.A", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi i Automjeteve per Institucionet e Komunes se Shtimes-Ri-tenderim" me nr. të prokurimit: "617-23-7688-2-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SHTIME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e kuotimit të çmimit, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 4 309.53 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Njoftimi për kontratë 24.07.2023

Hapja e Ofertave 01.08.2023

Njoftimi mbi vendimin e AK-së 07.08.2023

Kerkesa për Rishqyrtim 08.08.2023

Përgjigjje ndaj kërkesës për rishqyrtim 11.08.2023

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Te nderuar,

Me date 07.08.2023 kemi pranuar njoftimin ne lidhje me vendimin e Autoritetit Kontraktues per aktivitetin e prokurimit Sigurimi i Automjeteve për Institucione Komunes së Shtimës-Ri-tenderim ku ne kete aktivitet te prokurimit nga ana e A Kontraktues OE SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP DEGA KOSOVË eshte shpallur fitues edhe perkunder disa shkeljeve qe do i shp me poshte.

Pas pranimit te dokumentacionit nga Autoritetit Kontraktues, eshte verejtur qe A Kontraktues apo Komisioni vleresues nuk ka trajtuar me kujdes dokumentacioni prezantuar nga ana e OE ofertues, i cili me pas eshte shpallur edhe Fitues. Deri t vendim i Komisionit eshte ardhur duke mos perfillur ligjshmerine e dokumentac ligjor te prezantuar ne dosje tenderi. Komisioni i Autoritetit Kontraktues ka shpa Fitues nje OE i cili nuk ploteson kerkesat ligjore e cila eshte thelbesore dhe bazi vleresim.

Rasti konkret ka beje me pjesen financiare te ofertes se OE Sigma te cilen do e s

me poshte.

Ju njoftoj qe Industria e Sigurimeve mbikqyret drejtperdrejt nga Banka Qendrore e Kosoves dhe aktualisht operojne 10 Kompani te Sigurimeve te cilat mbikqyren nga Qendrore e Kosoves dhe asnje operator tjeter nuk ka te drejt te leshoj polica te sigu ne emer te kompanive pervec nese ka ndonje marreveshje konzorciumi per nje akti prokurimit me nje nga 10 kompanite e sigurimeve qe operojne ne Kosove.

Po te rikthehemi te kriteri i dhenies se kontratës: "Tenderi i përgjegjshem me çmim te ulet", fare lehte shihet qe cdo OE pjesemarres ne kete aktivitet te prokurimit filli duhet te jete i pergjegjshem duke qene ne perputhshmeri me tarifat e miratuara nga dhe pastaj eshte kriteri i cmimit me te ulet ne rastin konkret kur kemi te bejme me identike te OE atehere vlen kriteri i kohes se dorezimit te ofertes.

Te bashkengjitur kesaj shkrese po iu percjellim edhe tarifat e miratuara nga Banka Qendrore e Kosoves per 10 Kompani te Sigurimeve qe operojne ne Kosove dhe cd tjeter i dhene pervec atyre te miratuara nga Banka Qendrore e Kosoves perben shk si e tille e gjithe oferta e cilit do OE qe ka bere kete shkelje te qellimshme duhet te konsiderohet si e papergjegjshme. Linku ne te cilin mund te referoheni per tarifat e eshte: https://bqkkos.org/mbikeqyrja-financiare-2/mbikeqyrja-e-sigurimeve/tarifatdhebuletini-statistikor/

Konsiderojme qe ne Industrine e Sigurimeve ne kategorine e sigurimit MTPL gjera te percaktuara fare qarte nga Banka Qendrore e Kosoves, gje qe e konstaton edhe D Tenderit e juaja te pjesa III e kontrates Kushtet e vecanta, prandaj asnje OE per qef nuk mund ti ndryshoj cmimet e percaktuara me Ligj dhe te avantazhohet kundrejt konkurrences ne menyre te padrejte. Edhe ju si Autoritet Kontraktues e keni per det te jeni ne harmoni me Ligjet e Kosoves dhe ne asnje menyre nuk guxoni te pranoni qe bien ndesh me ligjet e Kosoves, vetem me arsyetimin e vetem qe jane me te lira. me e lire nuk mund te jete e pergjegjshme nese bie ndesh me Ligjet ne fuqi!

Ligji i zbatueshëm dhe gjuha
2.1 Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mb nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Duke marr parasysh te dhenat e mesiperme nuk eshte e mundur qe ne nje treg qe ta jane te percaktuara te jene disa operator te pergjegjshem e qe kane cmime te ndrysh e ritheksoj qe cdo ndryshim i cmimit per te perfituar eshte i denueshem dhe si i tille OE e ben te papergjegjshem, gje te cilen ju eshte dashte qe te reagoni ne kohe.

Nje gje te tille eshte sqaruar fare mire edhe tek Dosja e Tenderit apo tek pershkrimi cmimeve tuaja ku ju keni dhene Sqarim për OE: (Kompanit e Sigurimit) të cilat ma pjesë në këtë aktivitet të prokurimit , duhet që të jenë në harmoni me rregullat të përcaktuara nga BQK-ja gjatë ofertimit në bazë të grupit tarifor . Kompanit e siguri

cilat nuk u përmbahen këryre rregullave gjatë ofertimit do të eliminohen nga Vlersim

OE SIGMA gjate ofertimit qellimisht ka bere devijim te cmimit duke e avantazhuar padrejtesisht kundrejt konkurrences dhe njekohesisht shkeljet e meposhtme me automatizem e bejne OE SIGMA te papergjegjshem ne kete aktivitet te prokurimit. Shkeljet jane si me poshte:

Tek pozicioni nr 3 QKMF-ja OE SIGMA ka ofertuar me cmim per njesi TPL 198.24 duke bere devijim nga specifikimi teknik i pershkrimit te cmimeve qe keni dhene ju l kete automjet ju keni kerkuar qe te ofertojme per kubikazhe 1.9 dhe jo ne ndonje vle tjeter. Sipas dokumentit te vetem legjitim Tarifat e miratuara nga Banka Qendrore e Kosoves per Sigurimin e detyrueshem MTPL, tek Grupi tarifor I, cm3 Automjete pe pasagjer mund ta shihni qe keto automjete i perkasin kategorise 1701 – 1950 cm3, m sakte cmimi per TPL eshte 194.25 EUR e jo sic ka ofertuar OE i rekomanduar. OE SIGMA ka bere devijim te ky grup tarifor dhe nuk eshte ne perputhje me tarifat e aprovuara nga organi i vetem mbikqyres Banka Qendore e Kosoves andaj cdo cmim i dhene eshte shkelje e tarifave te BQK-se dhe me automatizem OE eshte i papergjegjshem.

Tek pozicioni nr 5 QKMF-ja OE SIGMA ka ofertuar me cmim per njesi TPL 233.10 duke bere devijim nga specifikimi teknik i pershkrimit te cmimeve qe keni dhene ju l per kete automjet ju keni kerkuar qe te jete per kubikazhe 2.8 Diesel dhe jo ne ndonj vlere tjeter. Sipas dokumentit te vetem legjitim Tarifat e miratuara nga Banka Qendr Kosoves per Sigurimin e detyrueshem MTPL, tek Grupi tarifor I, cm3 Automjete pe pasagjer mund ta shihni qe keto automjete i perkasin kategorise mbi 2701 cm3, me s cmimi per TPL eshte 313.79 EUR. OE SIGMA ka bere devijim te ky grup tarifor dh eshte ne perputhje me tarifat e aprovuara nga organi i vetem mbikqyres Banka Qend Kosoves andaj cdo cmim tjeter i dhene eshte shkelje e tarifave te BQK-se dhe me automatizem OE eshte i papergjegjshem.

Ju njoftoj qe cdo ndryshim i tarifes perben shkelje te tarifave te Kompanive te Siguri te aprovuara nga Banka Qendrore e Kosoves dhe si e tille e gjithe oferta duhet te konsiderohet si e papergjegjshme. Gjithashtu edhe ju si Autoritet Kontraktues fare qa keni precizuar kete pozicion qe cdo oferte duhet te jete ne harmoni me rregullat e percaktuara nga BQK-ja ne te kunderten OE e papergjegjshem do te eliminohen.

PROPOZIM

Propozojmë qe Organi Shqyrtues i Prokurimit te konsideroj si te BAZUAR për ri-shqyrtim dhe te kthej rastin ne RI_VLERESIM, duke shpallur te papergjegjshem O

SIGMA sh.a. dhe te shpalle fitues te ketij aktiviteti te prokurimit OE EUROSIG sh.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dështmia e kërkuar dokumentare*
A)Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit ose jeni në marrëveshje për shlyrjen e borgjeve, para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmerisë, të jetë i lëshuar së paku deri në gjashtë mujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratë	**A).Një deklaratë e shkruar nën B nënshkruar dhe vulosur nga tend përdorur formën e përcaktuar në tenderit. b).Vërtetim nga Adminis Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Themelore Departamenti për Qës Ekonomike (kopje). Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm nga ten fitues,para publikimit të dhënies s kontratës.Në rast të dështimit në dokumentave të nën B dhe nën C, do të refuzohet. AK do të vazhdoj tenderuesin e listuar të radhës.**
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dështmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit	**Dështmia 2. Certifikata e regjistri biznesit, ARBK me informatat p (kopje).**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna Shtime **shpërblen me kontratë :** SIGMA INTERALBANIAN VIENNA I
GROUP SH.A.- DEGA KOSOVË, Rr.Ukshin Hoti nr 13 Prishtine, 10000, PRISHTINI
në vlerë : 4,195.04

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues kualifikohet si pale me interes sipas nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.**

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

Përmbledhje e pretendimit ankimor

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë "SIGMA" gjatë ofertimit qëllimisht ka bërë devijim të çmimit duke avantazhuar veten padrejtësisht kundrejt konkurrencës dhe njëkohësisht shkeljet e mëposhtme me automatizëm e bëjnë OE "SIGMA" të pa përgjegjshëm

në këtë aktivitet të prokurimit. Në vijim po ju pasqyrojmë shkeljet:

Tek pozicioni nr. 3 QKMF-ja, OE "SIGMA" ka ofertuar me çmim TPL 198.24 Euro, duke bërë devijim nga specifikimi teknik i përshkrimit të çmimeve që keni dhënë ju ku për automjet ju keni kërkuar që të ofertojmë me kubikazh 1.9 dhe jo ndonjë vlerë tjetër. Sipas dokumentit të vetëm legjitim Tarifat e miratuar nga Banka Qëndrore e Kosovës për sigurimit e detyrueshëm MTPL, tek grupi tarifor I, cm3 Automjete për pasagjer mund ta shihni që këto automjete i përkasin kategorisë 1701-1950 cm3, më saktë çmimi për TPL është 194.25 Euro e jo siç ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, andaj OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë çmime të cilat nuk janë në përputhje me tarifat e aprovuara nga organi i vetëm mbikqyrës Banka Qenrore e Kosovës.

Përgjigjje në pretendimin ankimor 1

Eksperti Shqyrtues, sqaron se në lidhje me pozicionin nr.3 tek QKMF-ja, opertaori ekonomik i propozuar për kontratë ka ofertua me çmim për njesi 198.24 Euro. Kjo është në kundërshtim me tarifat e vendosura nga Banka Qendrore, për faktin se tek Grupi tarifor I cm3 prej 1701 deri 1950 është e përcaktuar tarifa 194.25 Euro.

AK ka vendosur një sqarim në paramasë duke theksuar se:

Sqarim për OE: (Kompanit e Sigurimit) të cilat marrin pjesë në këtë aktivitet të prokurimit , duhet që të jenë në harmoni me rregullat të përcaktuara nga BQK-ja gjatë ofertimit në bazë të grupit tarifor . Kompanit e sigurimit të cilat nuk u përmbahen këryre rregullave gjatë ofertimit do të eliminohen nga Vlersimi.

Andaj, nga përshkrimi i dhënë rezulton se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për shkak se nuk iu ka përmbajtur tarifave të BQK-së në lidhje me pozicionin nr.3 QKMF-ja. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

Përmbledhje e pretendimit ankimor

Tek pozicioni nr. 5 QKMF-ja OE "SIGMA" ka ofertuar me çmim për njesi TPL 233.10 Euro duke bërë devijim nga specifikimi teknik i përshkrimit të çmimeve që keni dhënë ju ku për këtë automjet ju keni kërkuar që të jetë për kubikazhe 2.8 Diesel dhe jo ndonjë vlerë tjetër. Sipas dokumentit të vetëm legjitim Tarifat e miratuara nga banka qëndrore e Kosovës për sigurimin e detyrueshëm MTPL tek grupi tarifor I, cm3 Automjete për pasagjer mund të shihni që këto automjete i përkasin kategorisë mbi 2701 cm3, më saktë çmimi për TPL është 313.79 Euro. OE "SIGMA" ka bërë devijim nga ky grup tarifor dhe nuk është në përputhje me tarifat e aprovuara nga organi i vetëm mbikqyrës i Bankës Qëndrore të Kosovës andaj dhe çdo çmim tjetër i dhënë është shkelje e tarifave të BQK-së dhe me automatizëm OE është i pa

përgjegjshëm.

Përgjigjje në pretendimin ankimor 2

Eksperti Shqyrtues, sqaron se në lidhje me pozicionin nr.5 tek QKMF-ja, opertaori ekonomik i propozuar për kontratë ka ofertua me çmim për njesi 233.10 Euro. Kjo është në kundërshtim me tarifat e vendosura nga Banka Qendrore, për faktin se tek Grupi tarifor I cm3 mbi 2701 është e përcaktuar tarifa 313.79 Euro.

AK ka vendosur një sqarim në paramasë duke theksuar se:

Sqarim për OE: (Kompanit e Sigurimit) të cilat marrin pjesë në këtë aktivitet të prokurimit , duhet që të jenë në harmoni me rregullat të përcaktuara nga BQK-ja gjatë ofertimit në bazë të grupit tarifor . Kompanit e sigurimit të cilat nuk u përmbahen këryre rregullave gjatë ofertimit do të eliminohen nga Vlersimi.

Andaj, nga përshkrimi i dhënë rezulton se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për shkak se nuk iu ka përmbajtur tarifave të BQK-së në lidhje me pozicionin nr.5 QKMF-ja. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SHTIME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.**

Gjemajli Bellanica

Gj. Bellanica